



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 6939/4 Prot.

Tiranë, më 13.10.2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 125, datë 13/10 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") është vënë në lëvizje nga shkresa e dërguar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Nr. 100/8 Prot/Q.Sh., datë 11.10.2022, protokolluar në institucion me Nr. 6939 Prot., datë 12.10.2022, e cila ka përcjellë pranë APP, Urdhërin datë 10.10.2022 të Prokurorit, për ekzekutimin e vendimit penal Nr. 34, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, për të dënuarën shoqërinë "Ra-Mi Kompani" shpk.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Ra-Mi Kompani" Shpk, me NIPT L61327009F, me adresë: Rruga "Tele Ndini", Pallati Nr. 1, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr. 3, Tiranë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me vendimin nr. 34, datë 26.05.2022, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të pandehurës shoqëria "Ra-Mi Kompani" shpk me Nr. NIPTI L61327009F, administrator B. Nika dhe ortak shtetasi A. Bushi, me seli Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 3, rruga "Tele Ndini", Pallati Nr. 1, kati 1, për veprën penale "Falsifikim i vulave, i stampave ose formularëve", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 190 paragrafi i dytë, të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 900.000 (nëntëqind mijë) lekë sipas neneve 8, 9 dhe 11, pika 4 gërma "c" e ligjit Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë".

- Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurave Penale, të pandehurës i ulet 1/3 e masës së dënimit për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe përfundimisht dënohet me 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

- Bazuar në nenet 8, 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", ndalimi i të pandehurës shoqëria "Ra-Mi Kompani" shpk të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike, me institucione shtetërore, qendrore apo vendore, për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh.

II. Masat:

Me Vendimin Nr. 125 datë 13.10.2022, APP ka vendosur ekzekutimin e Vendimit Penal Nr. 34, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për përjashtimin e operatorit ekonomik "Ra-Mi Kompany" shpk me NIPT L61327009F, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 2 (dy) vjet, deri në datën 29.09.2024.